



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 24.01.2012, në orën 13:00.
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu – Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Suzana Novobërdali.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Venera Mjekiqi- Kuvend, Lejla Selimi-OSBE, Besim Zeqiri-ICO.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Arkivat, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së;
5. Rikonfirmimi i grupeve punuese për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2012;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Arkivat, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari - E ftoi deputeten Vjosa Osmani, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Vjosa Osmani - Pas shqyrtimit konstatuam se ky projektligj, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

Përfundim

Projektligji për Arkivat, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE- së

Kryetari - E ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Blerta Deliu-Kodra - Pas shqyrtimit konstatuam se ky projektligj, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk rregullohet me legjislacionin e BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

Përfundim

Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk rregullohet me Acquis Communautaire.

5. Rikonfirmimi i grupeve punuese për zbatimin e Planit të Veprimit për vitin 2012

Kryetari i njoftoi anëtarët me grupet punuese, të cilat janë të ndarë në bazë të kriterëve politike, ekonomike dhe standardeve evropiane.

Në grupin për kriteret ekonomike janë propozuar: Xhavit Haliti- kryetar i grupit, Blerim Shala, Sasha Milosavljeviq dhe Vjosa Osmani.

Në grupin për kriteret ekonomike janë propozuar: Sasha Milosavljeviq- kryetar i grupit, Albert Kinolli, Suzana Novoberdaliu dhe Fatmir Limaj.

Në grupin për standardet evropiane janë propozuar; Alma Lama- kryetare e grupit, Lutfi Haziri dhe Blerta Deliu- Kodra.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:*

Përfundim

Miratohen këto grupet punuese për zbatimin e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për integritet evropian për vitin 2012.

6. Të ndryshme.

a) Shqyrtimi i fushëveprimtarisë së Komisionit.

Vjosa Osmani- anëtare e grupit punues për fushëveprimtarinë e Komisionit për Integritet Evropian i njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni Funkcional për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës nuk e ka përfshirë në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, fushëveprimtarinë e Komisionit, ashtu siç është kërkuar nga Grupi Punues. Kërkoj që të autorizohet Grupi Punues i Komisionit që është përgjegjës për fushëveprimtarinë që të punojnë me qëllim të inkorporimit të fushëveprimtarisë në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, ashtu siç është propozuar nga Komisioni.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:*

Përfundim

Autorizohet Grupi Punues i Komisionit që është përgjegjës për fushëveprimtarinë që të punojnë me qëllim të inkorporimit të fushëveprimtarisë në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, ashtu siç është propozuar nga Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri